



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 06-350-7971/15
Kaçanik, 28. 04.2015

Në bazë të nenit 12, të Ligjit 03/L-040 –Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 15 pika 1.2 e Ligjit Nr. 04/L-110 - Për ndërtimin, të nenit 5, pika 3.16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 09/2013 -Për Kategorizimin e ndërtimeve, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 28.04.2015, mori këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT KOMPANISË “AFA ENERGY” NGA PRISHTINA, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT ME KAPACITET, 2.4 MW NË VENDIN, “REKA E KOTLINËS”

1. Me këtë Vendim, i Jepet PËLQIMI, kompanisë “AFA ENERGY” Sh.p.k. nga Prishtina, për ndërtimin e Hidrocentralit, me kapacitet, 2.4 MW, në vendin e quajtur, “Reka e Kotlinës” në fshatin Kotlinë.
2. Hidrocentrali –objekti dhe shtrirja e tubacionit do të ndërtohet në ngastrën Nr.01299-0, të Z. K-le, Kotlinë, e evidentuar me çertifikatën Nr. 714-7778/2015, e lëshuar me datë 09.03.2015, e cila evidentohet si pasuri shtetërore e Kosovës- UJËRAT.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i komunës dhe drejtorja për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës,
2. Drejtorja për Urbanizëm, Kadasër dhe Mbrojtje të Mjedisit(përmes saj njoftohen organet tjera relevante),
3. Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,
4. Drejtorja për Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, dhe
5. Arkivi.

